

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR :
“KODRA MINING AND TUNNELLING” SHPK**

Sot, me date 24.05.2022, ne te nenshkruarit:

1. Mahmut Dalaslan, i datelindjes 15.09.1984, i biri i Ali dhe Sebiha, lindur Kayseri, Turkiye, dhe banues ne qytetin Lezhe, Shqiperi, me numer personal identifikimi 10559426046;
2. Martin Gjoni, i datelindjes 02.12.1981, i biri i Ndue dhe Tone, lindur dhe banues ne fshatin Gojan i Vogel, Njesia Administrative Gjegjan, Bashkia Puke, Shqiperi, me numer personal identifikimi I11202112U;

me vullnet te lire e te plote perpilojme kete Akt Themelimi.

Neni 1

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “Kodra Mining and Tunnelling”.

Neni 2

Shoqeria deklarohet e krijuar nen ruajtjen e plote te normave qe permban ky akt.

Neni 3

Veprimtaria e shoqerise, marredheniet e saj me personat e trete juridik e fizik, vendas e te huaj, shtetëror e privat, rregullohen ne baze te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si dhe te akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketij ligji. Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj.

Neni 4

Selia e shoqerise do te jete ne adresën: Rruga "Ymer Puka", Blloku Nr.1, Kati I-re, Numer Pasurie 35, Zona Kadastrale 3069, Bashkia Puke, Rrethi Puke, Qarku Shkoder, dhe per komunikime elektronike do te sherbej adresa e email-it: kodramining@gmail.com dhe mobil: ++0674065441

Neni 5

Veprimtaria e shoqerise, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete Akt-Themelimi nuk mund te ndryshojne pa pelqimin e themeluesve te saj.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

1. Kryerja e punimeve dhe shërbimeve gjeologjike, gjeofizike dhe konsulences në lidhje me zonat e eksploruara;



2. Kryerja e punimeve per shfrytezimin e minierave ne tunele, miniera nentokesore dhe siperfaqesore, perveç shitjes se mineraleve;
3. Nxjerrja e materialeve te percaktuara ne ligjin minerar te Republike se Shqiperise, si lende te para te industrise, duke perfshire: ari, argjendi, bakri, kromi, hekuri, plumbi, zinku, qymyri, nikel, minierat e gurit, minierat e rërës, mermeri dhe ujërat nëntokësore;
4. Kryerja e llojeve të ndryshme të përpunimit, funksionimit, përvetësimit, transferimit të materialeve dhe mineraleve;
5. Blerja, shitja, marrja/dhenja me qira, e çdo pajisjeje dhe mjeti të nevojshëm për nxjerrjen dhe përpunimin e këtyre mineraleve dhe materialeve.
6. Krijimi i objekteve të paketimit, funksionimi, marrja ose transferimi i tyre për produktet e prodhuara në magazina, porte, etj.;
7. Kerkimi dhe zbulimi ne fushen minerare, transferimi ose marrja e kërkimit, dhe administrimi paraprak i ushtrimit të së drejtës së zbulimit, administrimin e minierave per keto minerale, si dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave – përveç shitjes/importimit të mineraleve - të njohura nga ligji minerar në Shqiperi.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke e ndare ne dy kuota, me vlere nominale eshte 50.000 leke, te zoteruara nga, ortaket themelues:

1. Mahmut Dalaslan, zoteron nje kuote kapitali ne para, me vlere nominale 50.000 leke, e barabarte me 50 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise.
2. Martin Gjoni, zoteron nje kuote kapitali ne para, me vlere nominale 50.000 leke, e barabarte me 50 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise

Neni 8

Per nevoja te punes dhe te ushtrimit te aktivitetit te tyre shoqeria mund te çele llogari ne çdo banke te njohur me ligj, qofte kjo private apo shteterore.

Neni 9

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete mbi 10 vjet. Por ajo mund te ndryshojë afatin e ushtrimit të aktivitetit me vendim te asamblese se ortakeve.

Gjithashtu shoqeria mund te shperndahet edhe perpara ketij afati per rastet e parashikuara me ligj.

Neni 10

Administrator i shoqerise do te jete Martin Gjoni, i cili zgjidhet per nje afat 5 vjeçar me te drejte rizgjedhje, me numer pasaporte I11202112U.



Neni 11

Ortakët mbajnë përgjegjësi vetë për ruajtjen e karakterit të fshehtësisë së aktivitetit dhe të dokumentacionit të shoqërisë.

Neni 12

Organet e shoqërisë janë:

- 1- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve
- 2- Administratori i Shoqërisë, Martin Gjoni
- 3- Komisioni i eksperteve kontabel

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre përcaktohen në statutin bashkëngjitur.

Neni 13

Për nevojat e punës kjo shoqëri mund të përdorë edhe punëtorë të specializuar të ndryshëm, me kontratë pune të rregullta sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 14

Dispozitatë me të hollësishme për shoqërinë përcaktohen në statutin bashkëngjitur.

Neni 15

Ky akt themelimi u redaktua në dy kopje.

Administratori, Martin Gjoni do të kryej regjistrimin sipas procedurave në QKB të kësaj shoqërie.

ORTAKËT THEMELUES:

Martin Ndue GJONI

Martin Ndue Gjoni

Mahmut Ali DALASLAN

Mahmut Ali Dalaslan